



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:216522

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05477756

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas gjyqtarit Musë Povataj me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.. M., për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1645/23 e datës 12.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 04.10.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 13.02.2024 dhe 14.02.2024 të mbyllur për publikun, në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të akuzuarit B.. M.. dhe të dëmtuarës E.. K., me datë 20.02.2024 mori dhe shpalli publikisht ndërsa me datës 20.03.2024 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.. M.., i lindur me, në fsh. N.... K.. P.., ku edhe banon, nga babai T... dhe nëna Sh..., e gjinisë A..., i pa martuar, i punësuar, ka të kryer shkollën fillore, me gjendje të dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr...., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës, *mbrohet ne liri*.

Konform nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së.

LIROHET NGA AKTAKUZA

Për shkak se:

Me dt. 25.8.2023, rreth orës 17:00, në fsh. N... në P.., pikërisht në shtëpinë e tij, brenda marrëdhënies familjare, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarës E.. K.- të cilën e ka bashkëshorte, në atë mënyrë që, ditën kritike, derisa e dëmtuara dhe i pandehuri ishin në shtëpi, i pandehuri e kërkon një mbushës te telefonit, gjersa e dëmtuara i tregon që e ka marrë djali dhe del nga dhoma, i pandehuri acarohet duke shkuar pas të dëmtuarës, të cilës fillimisht i drejtohet me fjalët “*pse po bërtet*” dhe pastaj e godet me grushta në fytyrë, me ç’rast e njëjta ka pësuar lëndime trupore.

- me çka kishte për të kryer veprën penale sulm nga neni 184 par 1 të KPRK-së

E dëmtuara E.. K.. nga fsh. N.., K. P.., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve.

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngrit aktakuzën, PP/II.nr.1645/23 e datës 12.10.2023, kundër të pandehurit B.. M.. , për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Ndërsa ne shqyrtimit kryesorë të datës 14.02.2024 Prokuroria Themelore në Pejë e ka rikualifikuar veprën penale duke e akuzuar të pandehurit për veprën penale të sulmit nga nenin 184 par. 1 të KPRK-së.

Me datën 13.02.2024 dhe 14.02.2024 gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësorë në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të akuzuarit B.. M.. dhe të dëmtuarës E.. K..

Prokurorja e shtetit Ardiana Veseli në fjalën përfundimtare drejtpërsëdrejti ë procesverbal ka deklaruar: në mbështetje te nenit 353 pa1 te KPPK-së paraqes pran kësaj gjykate faljen përfundimtare sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.1645/23 të datës 12.10.2023 ndaj te pandehurit B.. M.. për shkak te veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u administruan provat materiale dhe personale ne drejtim te veprës se lart cekur, kishim mundësi te dëgjonim këtu te dëmtuarën E.. K.. e cila gjate deklarimit te saj ditën kritike e pranon se kishte një mosmarrëveshje më burrin e saj këtu te pandehurin B.. por nuk pranon se lëndimet trupore te ja kishte shkaktuar bashkëshorti i saj, pasi qe edhe gjate deklarimit te saj ne stacionin policor ne Pejë e po ashtu edhe gjet këtij shqyrtimi gjyqësor e njëjta e pranon se “nga nervoza e kam goditur veten, e kam grithur fytyrën me duar, deri sa bashkëshorti im vetëm me ka shtyrë me duar nuk me ka goditur” duke shtuar se unë nuk e kam lajmëruar rastin ne polici por vëllai im, ndërsa këtu i pandehuri B.. deklaron se kishim një mosmarrëveshje me te dëmtuarën sa i përket një adapteri telefoni, nuk e kam godit te njëjtën por ajo e ka goditur veten duke e goditur fytyrën, pasi kur fjalosemi e njëjta e godet veten, i njëjti shton se me vëllain e bashkëshortes nuk kemi raporte te mira ku edhe i njëjti ja mbush mendjen bashkëshortes time duke i thënë shko deklaro ne polici kundër B.., deklaroj se ditën kritike nuk e kishte lajmuar bashkëshortin e saj ne polici për veprën penale dhuna ne familje por rasatin ne polici e kishte raportuar vëllai i te dëmtuarës, ndërsa arsyeja ishte se atë dit e dëmtuara ishte nervozuar me bashkëshortin e saj për një adapter telefoni dhe me ketë rast kishte ardh deri tek një zenk ne mes tyre, po ashtu e njëjta deklaron se nuk është vërtet ajo çfarë ka deklaruar ne polici pasi qe e dëmtuara e kishte goditur veten ne grushte ne fytyrë sepse kështu

vepron kur behet nervoz, *andaj nga te lart cekurat bëjmë rikualifikimin e veprës penale kundër te pandehurit B.. M.. dhe atë ne veprën penale sulmi nga neni 184 par 1, duke i propozuar gjykatës qe i njëjti te shpallet fajtor dhe te dënohet si pas ligjit.*

E dëmtuara E.. K.. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e përkrahi fjalën e prokurores se shtetit.

I akuzuari B.. M.. në fjalën përfundimtare të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: ,edhe pas rikualifikimit te veprës penale te prokurorisë unë nuk e ndiej veten fajtor ngase unë vetëm e kam prek dhe unë ja le ne vlerësim gjykatës, sepse unë vetëm e kam shty ne faqe dhe i kam thënë gjeje adapterin.

3. Konstatimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPPRK-së gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi këtë gjendje faktike:

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari B.. M.. ka kryer veprën penale sulm nga neni 184 par 1 të KPRK-së në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

Gjykata për vërtetimin e plote dhe te drejte te gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit të dëmtuarën E.. K...

Ndërsa gjykatë shqyrtimit janë administruar këto prova materiale: raporti policor i përpiluar nga zyrtari policor B.. S.. me dt. 25.8.2023; deklarata e të dëmtuarës e dhënë në polici më dt. 25.08.2023; raporti mjekësor me numër protokollit i dt. 25.8.2023, deklarata e të pandehurit e dhënë në polici më dt. 25.8.2023 si dhe akt ekspertimi mjeko- ligjor dt. 29.9.2023, i kryer nga Dr. F.. D., si dhe i pandehur mbrojtjen e tij e ka dhënë me deklaram.

4.1 Deklaratat e dëshmitareve

4.1.1. E dëmtuara E.. K.. gjatë shqyrtimin gjyqësor në cilësi të dëshmitares ka deklaruar se: rastin ne polici me datë 25.08.2023 nuk e kam lajmurar, ,mirëpo vëllai im e ka lajmërua, ngase unë e kam thirr babën dhe vëllai e ka marr vesh, nuk më lajmëroj sepse jemi familje , pak kemi pas problem me te *pandehurin , unë i kam pas fajet aty sepse ju kam gjuajt te pandehurit ndërsa ky vetëm më ka shty*, ndërsa me pas unë ja kam hi vetit ne fytyrë me te dy duart ne mollëzat e fytyrës.

Në pyetje të Prokurores se: a te kujtohet qka ke deklarua ne polici, e dëmtuara ka deklaruar: po me kujtohet, unë e kam grith veten dhe ja kam hi me grushta vetes, në polici ju kam thënë se me ka rreh burri unë jam nervozua sepse unë shpesh kur behëm nervoz e rrehu veten, i pandehuri

nuk me ka godit asnjëherë me grushtua dhe ato qe kam thënë ne polici nuk janë te vërteta sepse si po flas sot kam fol edhe atë dit, mirëpo atë dit unë kam shkuar te mjeku, i pandehuri ndonjëherë para këtij rasti me ka shkaktua dhunë ne familje por se kam lajmërua, ndërsa kur jam shku te doktori me pyeti se çfarë ki unë i thash se pak ma ka hi burri dhe pastaj e ka godit veten dhe e kam grith fytyrën, i pandehuri vetëm me ka shty dhe e dëmtuara e shpjegon edhe mënyrën e shtyrjes dhe atë shtyrje te lehtë por jo goditje, vëllai im M.. me tha ti kam thirr policin sepse shumë ja ka inati te pandehurit.

4.2 Provat materiale

4.2.1. Nga raporti policor i përpiluar nga zyrtari policor B.. S.. me dt. 25.8.2023 gjykata ka konstatuar se me datë 25.08.2023 ne ora 17:30 jemi informuar për rastin, patrulla ka shkuar ne vendngjarje dhe ka takuar te dëmtuarën dhe të pandarin, ndërsa e dëmtuara ka deklaruar se gjatë fjalosjen i pandehuri e kishte goditur te dëmtuarën me grushte ne fytyre ndërsa i pandehuri është arrestuar.

4.3 Mbrojtja e të akuzuarit

4.3.1. I akuzuari B.. M.. në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor, në mes tjerash ka thënë se: me vëllain e bashkëshortes këtu te dëmtuarën nuk i kemi raport e mira dhe aj M..K.. ja ka mbush mendjen te dëmtuarës duke i thënë shko beje ketë deklarim ne polici , ndërsa ditën kritike ka qen dit pushimi unë rash me pushu dhe unë e lypa një kabell dhe e dëmtuara mu përgjigj agresiv dhe un e vetëm e kam prek ne faqe, sa i përket familjes unë jam i qet dhe pasi e dëmtuara ka fol me babin e saj te cilit i tha se i pandehuri po me bën fjalë për një adapter , unë jam larguar ne atë moment pastaj qka kanë bisedua nuk e di, mirëpo e dëmtuara me ka thënë se M.. i thirr policin, sepse po te kisha kryer ndonjë veprim unë do ta kisha pranuar veprën.

Në pyetje të Prokurores se: a e ke shty te dëmtuarën atë ditë, i pandehuri ka deklaruar: po, e shpjegova me herët, (unë vetëm e kam prek ne faqe), prej asaj dite nuk kemi pas probleme me të dëmtuarën.

Ndërsa në deklaratën e dhënë ne Prokuroi me datë 25.08.2023 i akuzuari e ka mohuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

5. Elementet e veprës penale

Në nenin 184 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se veprën penale të sulmit e kryen: kushdo ***që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër***. Pra elementi kryesor i kësaj vepre penale është përdorimi i forcës me dashje ndaj personit tjetër

6. Faktet jo kontestuese.

Për gjykatën nuk është kontestuese fakti se i pandehuri dhe e dëmtuara janë bashkëshort dhe në këtë bashkësi martesore kanë 8 fëmijëve, 3 fëmijë i ka me aftësi te kufizuar te cilët nuk i flasin,

punon mirëmbajtës në një restorant, nga pasuria e paluajtshme ka një shtëpi, raportet tani i kanë të mira, mirëpo ditën kritike kanë pasur një fjalosje rrethe një adapteri.

7. Faktet Kontestuese.

Kontestuese për gjykatën deri në përfundim të shqyrtim gjyqësorë ishte fakti nëse i pandehuri të dëmtuarën e kishte sulmuar duke goditur me shuplak në fytyrë.

Mirëpo gjatë shqyrtimi gjyqësorë këto fakte nuk janë vërtetuar në mungesë të provave ngase nuk është vërtetuar me asnjë provë materiale apo personale nëse i akuzuari i ka ndërmarr veprimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

8. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata pas administrimit të provave, analizimit të tyre me shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se duhet t'i falet besimi i plotë deklaratës së të akzuarit i cili ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar, për shkak se një deklarami i tillë, gjënë mbështetje në deklaramin e tij të mëparshme, të dhënë para zyrtarëve policor ku e kishte mohuar kryerjen e kësaj veprës penale e po ashtu deklarata e tij nuk ka renë në kundërshtim me asnjë provë materiale të administruar në shqyrtim gjyqësor, e duke marr parasysh se e dëmtuara në shqyrtim gjyqësor e ka pranuar se a ka goditur veten, të cilat lëndime janë konfirmuar nga ana ekspertizës mjekoligjore, mirëpo të njëjtat lëndime nuk i ka shkaktar i pandehuri për çka ka rezultuar edhe me rikualifikimin juridik të veprës penale nga ana e Prokurorisë nga vepra penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së, në veprën penal të sulmit nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata edhe për kundër rikualifikimit juridik të veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nuk ka vërtetuar se në veprimet e të pandehurit janë konsumuar elementet e veprës penale të sulmit nga neni 184 par. 1 të KPRK-së duke marr parasysh deklaratën e vetë të dëmtuarës në shqyrtim kryesor e cila ka theksuar se “ pak kemi pas problem me të *pandehurin, unë i kam pas fajet aty sepse ju kam gjuajt te pandehurit ndërsa ky vetëm më ka shty, ndërsa me pas unë ja kam hi vetit në fytyrë me te dy duart në mollëzat e fytyrës*” po ashtu ka deklaruar po me kujtohet, unë e kam grith veten dhe ja kam hi me grushta vetes, në polici ju kam thënë se me ka rreh burri unë jam nervozua sepse unë shpesh kur behëm nervoz e rrehu veten, i pandehuri nuk me ka godit asnjëherë me grushtua dhe ato që kam thënë në polici nuk janë të vërteta sepse si po flas sot kam fol edhe atë ditë, mirëpo atë ditë unë kam shkuar te mjeku, i pandehuri ndonjëherë para këtij rasti me ka shkaktua dhunë në familje por se kam lajmërua, ndërsa kur jam shku te doktori me pyeti se çfarë ki unë i thash se pak ma ka hi burri dhe pastaj e ka godit veten dhe e kam grith fytyrën, i pandehuri vetëm me ka shty dhe e dëmtuara e shpjegon edhe mënyrën e shtyrjes dhe atë shtyrje të lehtë por jo goditje, vëllai im M.. me tha ti kam thirr policin sepse shumë ja ka inati te pandehurit.

Prandaj gjykata i ka falë besimin mbrojtjes së të akuzuarit i cili ka mohuar kryerjen e veprës penale edhe të sulmit ngase mbrojta e tij nuk ka renë në kundërshtim me asnjë provë materiale apo formale të administruar ne shqyrtim gjyqësor.

Prandaj gjykata duke marr parasysh se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penale interpretohen ne favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata duke vlerësuar dëshminë e të dëmtuarës të njëjtës dëshmi nuk i ka falë besimin ne drejtim të elementeve të veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehurit, ngase e njëjta deklaratë nuk ka mbështetje ne asnjë provë tjetër personale apo materiale dhe ka rënë në kundërshtim të plotë me mbrojtjen e të pandehurit.

Nga raporti i policit B.. S.. me dt. 25.8.2023 është vërtetuar se me datë 25.08.2023 ne ora 17:30, patrulla ka shkuar ne vendngjarje dhe ka takuar të dëmtuarën dhe të pandarin.

Prandaj meqenëse, nuk kemi ndonjë provë bindëse, me të cilën do të vërtetohej përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari i ka ndërmarr veprimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata ka vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj nga dëgjimi i të dëmtuarës si deklaratë e vetme në bazë të së cilës është bazuar aktakuza gjykata nuk ka mundur ta vërtetoj faktin se në kohën e përshkruar si ne dispozitiv të aktakuzës i akuzuari i ka ndërmarr ato veprime ngase kjo deklaratë ka rënë ne kundërshtim të plot me deklaratën e të akuzuarit B.. M.. i cili e ka mohuar veprën penale në të gjitha fazat e procedurës penale.

Andaj, gjykata pas analizimit të të gjitha provave ka konstatuar se nuk është vërtetuar se këtu i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, prandaj gjykata mori aktgjykim lirues për faktin akuza ka mbetur nën nivelin e dyshimit të arsyeshëm dhe jo në atë të bazuar mirë në prova të artikuleshme dhe të besueshme se i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilin ngarkohet andaj në mungesë të provave gjykata e ka liruar nga akuza.

9. Vendimi për lirimin e të akuzuarve nga akuza

Lidhur me pretendimet e Prokurorisë se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata pas administrimit të provave, ka vlerësuar me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së të njëjtin e liroj nga akuza.

Me dispozitën ligjore të nenit 3 par. 2 të KPPRK-se është përcaktuar se: mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penale interpretohen ne favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, andaj meqenëse ne rastin konkret të gjitha provat e administruara e dëshmojnë pafajësinë e të akuzuarit, për veç deklaratës së të dëmtuarës e cila

deklaratë ka mbetur si prove e vetme, e pa mbështetur ne prova të tjera dhe në kundërshtim me deklaratën e të pandehurit, e ne kuptim te nenit 8 par. 1 dhe 2 te KPPRK-se gjykata vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit.

Me dispozitën ligjore te nenit 257 te KPPRK-se është përcaktuar se gjykata nuk e shpall fajtor te akuzuarin duke u mbështetur vetëm në një dëshmi.

Me dispozitën ligjore të nenit 7 të KPRK-së është përcaktuar se: gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.

Me dispozitën ligjore të nenit 8 të KPRK-së është përcaktuar se: gjykata në punën e saj është e pavarur dhe vendos në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. Gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor. Prandaj asnjë nga provat e verifikuara ne shqyrtim gjyqësore nuk është vërtetuar se i pandehuri i ka kryer veprën penale për të cilat është akuzuar nga ana e Prokurorisë.

10.Lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Komfor nenit 462 par. 3 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

11. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar nenin 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2023:216522, 20.03.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.